

DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



KOMISIONI I EKONOMISË SHTYN PËR NË SHTATOR DISKUTIMIN E AMNISTISË FISKALE

Komisioni parlamentar i Ekonomisë dhe ai i Ligjeve kanë shtyrë për në shtator shqyrtimin e projektligjit të amnistisë fiskale. Ky vendim u mor pasi u mbledhën të gjitha rekomandimet nga grupet e interesit, si shoqatat e biznesit, shoqata e bankave, prokuroria si dhe nga faktori ndërkombëtar, si “Fondi Monetar Ndërkombëtar”. Sipërmarrja ka bërë propozime për disa ndryshime në draftin e amnistisë mes tyre edhe lidhur me detyrat që do të ketë njësia speciale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



“AGRO CHALLENGE”, MUNDËSIA E TË RINJVE NË FUSHËN E AGROBIZNESIT

Konkursi “Agro Challenge”, një sfidë startup-esh në fushën e turizmit, inovacionit dhe shërbimeve sapo ka zgjedhur fituesit e tij “Alpine Bees” dhe “Vajra Malësie”. Dy sipërmarrje të vogla të cilat do të përfaqësojnë Shqipërinë dhe do të konkurrojnë për të fituar çmimin prej 20 mijë eurosh në “Global Agripreneurs Summit” i cili do të mbahet në Tetor 2020 në Greqi. Në eventin final të konkursit të ideve të biznesit “Agro Challenge” u prezantuan 11 statup-e përpara një jurie ku pjesë ishte edhe z. Ardian Lekaj, sipërmarrës dhe kryetar i Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



RAPORTI/ 76% E PROFESIONISTËVE NË DIASPORË DUAN TË KONTRIBUOJNË NË VENDLINDJE

Organizata “Germin” ka publikuar një anketë të kryer me rreth 921 ekspertë nga Diaspora mbi angazhimin profesional në vendet e origjinës. Publikimi u prezantua në një takim online ku i pranishëm ishte dhe ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko. Fuqizimi i grupeve dhe organizatave të Diasporës është një faktor shumë i rëndësishëm që ndikon në përkushtimin e Diasporës për një angazhim më intensiv dhe të strukturuar në vendet e origjinës gjithashtu zhvillimi i një platforme shumë-funksionale që të lidhë profilet e profesionistëve të Diasporës me sektorin publik dhe privat në vendet e origjinës. Kjo platformë aktualisht funksionon dhe mund të gjendet online si ‘Rrjeti i profesionistëve të Diasporës’.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



JAVA NË LAJME :

KKD I KËRKON KANCELARES MERKEL
LIBERALIZIMIN E VIZAVE PËR QYTETARËT E KOSOVËS



RINAS/ JA TË GJITHA FLUTURIMET
E KONFIRMUARA PËR SOT



PARLAMENTI MIRATON LIGJIN, ZGJIDHJE
PËR FËMIJËT QË KANË LINDUR JASHTË



KURSI I KËMBIMIT

MONEDHA	BLERJE	SHITJE
USD	104. ⁷⁰	106
EUR	123. ³⁰	124. ¹⁰
CHF	113. ⁸⁰	115
GBP	134. ⁷⁰	136. ⁷⁰
DKK	16. ¹⁰	16. ⁶⁴